



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 03.06.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rrugore në territorin e Bashkisë Durrës”- **Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomik, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 12 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër**”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Shërbimet të modelimit të projekteve-72242000-3; Projektimi dhe ekzekutimi i kërkimeve dhe zhvillimit-73300000-5; Shërbim për projektim ndërtesash-71221000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 33,332,133.44 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë e tre pikë dyzet e katër) Lek pa TVSH ose 338,913.4 (treqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë pikë katër) Euro pa TVSH.

Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 02.06.2025, me kurs këmbimi 98.35 Lek.

Afati i realizimit të shërbimeve është 12 (dymbëdhjetë) muaj, nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË
KONTRATËS**

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.23, datë 24.01.2025 dhe nr.1298 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t`u kryer në programet e investimeve.

Grupi i punës i pasi u njoh me objektin e punës, programoi punën për përllogaritjen e vlerës së projektit, duke u mbështetur në këto dokumenta:

1. V.K.M. 354, datë. 15.01.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.
2. Investime të kryera nga Bashkia në objekte të ngjashme.
3. Buxhetin e Bashkisë Durrës

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

- a) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritetet tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Për llogaritjen e vlerës së projektit grupi i punës, sic edhe është theksuar më lart është mbështetur në VKM 354 dt. 15.01.2016, dhe në punime të ngjashme.

Llogaritja e vlerës së kësaj marrëveshjeje kuadër u bë duke u mbështetur në investimet e bëra në:

1. Infrastrukturë rrugore e kanalizimesh
2. Ndërtim shkolla
3. rehabilitimi sheshe
4. projekte rirforcimi pallatesh dëmtuar nga tërmeti
5. përforcime terrenesh nga rrëshqitjet

Në bazë të kontratave të ngjashme dhe vlerave mesatare që dolën: Vlera maksimale e projekteve që parashikohen të realizohen me anë të kësaj marrëveshje kuadër është paraqitur me anë të tabelës së mëposhtme:

Projekte qe parashikohen te investohen nga Bashkia Durrës për vitet 2025-2027								
Nr.	Emërtimi i projektit	sip- m2 ose gjatesi ml	Vlera per njesi (leke/m2 ose leke/ml)	Vlera e plotë e investimit pa tvsh	SEKSIONI DHE GRUPI TARIFOR KU BEN PJHESE PROJEKTI (SIPAS VKM 354 date 11.05.2016)	Vlera e projektit per te gjithë fazat(SIPAS VKM 354 date 11.05.2016)	% e fazave qe kerkojme te realizohet sipas ndarjeve te seksioneve	Vlera e fazave te projektit (FAZA I-VI, SIPAS VKM 354 date 11.05.2016)
1	Studim projektim I rrjetit te kanalizimeve te ujrave te bardha zona e Stadiumit Niko Dovana	260000 m2			(SEKSIONI III) VEPRA INXHINIERIKE, GR TARIFOR 3			
2	Studim projektim rruga Sirius	2200 ml			SEKSIONI IV STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT, gr tarifar 3			
3	Studim projektim mbulim I pishines	2930 m2			SEKSIONI II STRUKTURAT E ABMJENTEVE TE JASHTME, GR TARIFOR 3			
4	Studim projektim ndertim kopesht, cerdhe ne zonen e Durrësit te Ri	1032 m2			SEKSIONI I NDËRTHESAT DHE NDARJET FUNKSIONALE TË TYRE, gr.tarifar 3			
5	Studim projektim parkim nentokesor	624 m2			SEKSIONI I NDËRTHESAT DHE NDARJET FUNKSIONALE TË			
6	Studim projektim ndertim rruga "Kuvendi I Vlores" dhe "Celislami"	1250 ml			SEKSIONI IV STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT, gr tarifar 3			
7	Masterplan per unifikim urban me rrugen Shoqata e Durrësit, zone per cerdhe, kopsht kend lojrash etj							
	Rruge	3000 ml			SEKSIONI IV STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT, gr tarifar 3			
	Sheshe	2500 m2			SEKSIONI II STRUKTURAT E ABMJENTEVE TE JASHTME, GR TARIFOR 3			
	godina kopesht cerdhe	1500 m2			SEKSIONI I NDËRTHESAT DHE NDARJET FUNKSIONALE TË TYRE, gr tarifar 3			
	(Hartim I planit të lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane në bashkinë Durrës "City Bus")							
8	Studim projektim rrjeti kub lagjia nr.14	2313442 m2			(SEKSIONI III) VEPRA INXHINIERIKE, GR TARIFOR.2			
9	Studim projektim I perforcimit te terrenit nga rreshqitjet, zona e Porto Romanois	750 m2			KREU IV PROJEKTET SPECIFIKE, SEKSIONI I PROJEKTIMI I STRUKTURAVE ME AFTËSI MBAJTËSE, gr			
10	Hartimin i projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese – përshtatëse të nevojshme, për riaftësimin strukturor të pallateve të demtuara nga termeti i dates 26.11.2019, GIS 322 Andon Boshnjaku	5212 m2			VKM 26. Datë 15.01.2020			
					SHUMA TOTALE E PROJEKTEVE PA TVSH			

Grupi i punës u mbështet në llogaritë e mësipërme sipas VKM 354, vlera fondit limit për projektin: “Hartimi i masterplaneve dhe/ose përgatitje të projekteve teknike të detajuara, dhe/ose të projekteve të zbatimit për objekte civile, industriale, sportive, residenciale, vepra të ujitjes-kullimit dhe infrastruktura rrugore ne territorin e Bashkisë Durrës”, rezultoi të jetë: **33,332,133.44** (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e

dy mijë e njëqind e tridhjetë e tre pikë dyzet e katër) Lek pa TVSH ose **338,913.4** (treqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë pike katër) Euro pa TVSH.

Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 02.06.2025, me kurs këmbimi 98.35 Lek.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, nenin 41, pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kësaj kontrate është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. **Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës**” dhe nenin 43 pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është mbi vlerën e kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës. Sa më lartë, nga ana e Njesisë së Prokurimit është arsyetuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke iu referuar faktit se në bazë të përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së kontratës në kërkesën për kualifikim por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri

audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kërkesa për paraqitjen e balanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar të kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në fushën e projektimit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të gjitha entet e tjera përgjegjëse:

1. PROJEKTUES URBANIST

c-Plane të detajuara vendore

2. PROJEKTUES ARKITEKT

a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.

b-1. objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 2. qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore; 3. objekte spitalore; terminalët në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.

c- Projektim interiere.

d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a) Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

b) 1. Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate – 2. objekte me skelet metalik.

c) 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

a) Instalime hidrosanitare.

b) Instalime termoteknik–ventilimi-kondicionimi.

c) Linja e rrjeta elektrike–telefonike–radiotelefoni– citofoni–sistem alarmi–televiziv etj. Për objekte civile, industriale, turistike.

f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.

h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.).

i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b) Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

c) Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale.

d) Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga deri 10m - damba.

6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

a) Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

b) Projektim rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

a) Ura dhe vepra arti të vogla deri me 10 m.

d) Ura metalike.

8. PROJEKTUES GJEODET

- a- Rivelime inxhinierike.
- b- Rilevime inxhinierike kadastrale.

9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
- b) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike mbi 5 kate.
- d) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- e) Studime e projekte hidrogjeologjike.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

- e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

- a) Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- d) Sinjalistike ndricuese ne infrastrukture

12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/subjekte juridike).

- a) Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.
- b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimnr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" .

PROJEKTUES URBANIST (1- c), 2. PROJEKTUES ARKITEKT (2. a, b-1, b-2, b-3, c, d)

(Ai/ajo do të jetë përgjegjës për Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, godina , fasada, ndarjet funksionale etj...hartim masterplanesh.)

PROJEKTUES KONSTRUKTOR (3 a,b-1,b-2,c-1,c-2,)

Udhëheqësi i Ekipit do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme teknike dhe administrative të detyrës, koordinimin e ekipit të ekspertëve, planifikimin dhe ecurinë e aktiviteteve, koordinimin me palët e interesuara, menaxhimin financiar, raportimin dhe asistencën e përgjithshme teknike në menaxhimin e projektit. Kërkohet për realizimin e projekteve konstruktive të llojeve të ndryshme deri në 5 kate psh shkolla, kopshte, cerdhe dhe mbi 5 kate në rastet e rforcimit ose rindërtimit.

PROJEKTUES INSTALATOR (4.a, b,c,f,h,i)

- Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektimin e projekteve hidroteknike, për projektet elektrike dhe të automatizimit të veprave të komandimit dhe sistemit monitorimit, për projektet mekanike, sinjalistike dhe automatizimit të veprave të komandimit.

PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE(5.b,c,d)

Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektimin e projekteve hidroteknike, kanalizime, vepra kullimi etj.

PROJEKTUES RRUGE – HEKURUDHA (6.a,b)

Kërkohet për arsyen se projektuesi i rrugëve do të realizojë projektin e rrugës lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore

PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI (7.a,d)

Kërkohet për projektimin e urave të ndryshme.

PROJEKTUES GJEODET (8.a,b)

Kërkohet për arsyen se projektuesi gjeodet do të realizojë rilevimin topografik të gjithë zonës ku do të zhvillohet projekti si edhe për hartat dhe raportet e shpronësimeve .

STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK (9.a,b,d,e)

Kërkohet për hartimin e raporteve të ndryshme gjeologjike për projekte të llojeve të ndryshme, godina, rrugë, mure mbajtës, rforcime pallatesh nga tërmeti etj

PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (10.e)

Kërkohet për hartimin e projekteve elektrike si kabina , linja tension I mesëm e I ulët.

PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR (11.a,d)

Kërkohet për hartimin e projekteve të sinjalistikës rrugore.

STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/subjekte juridike) (12.a,b)

Kërkohet për hartimin e studimeve sizmiologjike ose raporteve të ndryshme.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- 1(një) Inxhinier Ndertimi

- 1 (një) Arkitekt/Urbanist
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mjedis
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf;
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Gjeofizik /Sizmiolog;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

Staf mbështetës:

- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi profili transport
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Gjeoteknik
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga agjencia e efikences se energjise “ Certificate per auditues energjitike”
- 1(një)Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh.
- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës;
- 1 (një) Ekspert Arkeolog/Restaurator
- 1 (nje) punonjes i pajisur me certificate si “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M Nr.312,date 05.05.2010 “Per miratimin e rregullores “Per sigurine ne kantier”.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për personelin kryesor operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë;
- Kontratë pune (e vlefshme) dhe CV;
- Licencat individuale profesionale në projektim;
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit. Për këtë duhet të dorëzohen listpagesat sipas legjislacionit në fuqi.

Për stafin mbështetës operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë;
- Kontratë pune (e vlefshme) dhe CV;
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën muajin e fundit. Për këtë duhet të dorëzohen listpagesat sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si

dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të natyrës së objektit dhe projektit që do të realizohet si dhe në bazë të kategorive të licencave të kërkuara konkretisht:

- **Inxhinier Ndertimi** lidhet me kategorinë e licencës: PROJEKTUES KONSTRUKTOR (3 a,b-1,b-2,c-1,c-2,)
- **Arkitekt/Urbanist** lidhet me kategorinë e licencës: PROJEKTUES URBANIST (1- c), 2. PROJEKTUES ARKITEKT (2. a, b-1, b-2, b-3, c, d)
- **Inxhinier Hidroteknik** lidhet me kategorinë e licencës PROJEKTUES INSTALATOR (4.a,f,5.b,c,d)
- **Inxhinier Mjedis** është i nevojshëm për anën mjedisore të projekteve që të jetë konform kushteve për ruajtjen e mjedisit dhe legjislacionit në fuqi.
- **Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf** lidhet me me kategorinë e licencës PROJEKTUES GJEODET (8.a,b)
- **Inxhinier Gjeolog** lidhet me me kategorinë e licencës STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK (9.a,b,d,e)
- **Inxhinier Gjeofizik /Sizmiolog** lidhet me kategorinë e licencës STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (12.a,b)
- **Inxhinier Elektrik** lidhet me kategorinë e licencës: PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (10.e) dhe PROJEKTUES INSTALATOR (4.c).
- **Inxhinier Mekanik** lidhet me kategorinë e licencës: PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR (11.a,d) dhe PROJEKTUES INSTALATOR (4.h,i).

Staf mbështetës:

- 1 (një) Arkitekt kërkohet në mbështetje të arkitektit kryesor.
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi profili transport kërkohet në mbështetje të hartimit të projekteve të ndryshme të rrugës, urave tj.
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist kërkohet si mbështetës i inxhinerit konstruktor kryesor.
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik kërkohet si mbështetës i inxhinerit hidroteknik kryesor.
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet si mbështetës i inxhinerit gjeodet kryesor.
- 1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Gjeoteknik kërkohet për projektet e përforcimit të terreneve nga rrëshqitjet dhe si mbështetës në projektet e themeleve etj.
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis shërben për hartimin e raporteve të vlerësimit në mjedis VNM etj.
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga agjencia e eficeses se energjise “ Certificate per auditues energjitike” përgjegjës përgatitjen e e auditit te energjiise nese do kerkohet.
- 1(një)Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh do të jetë përgjegjës përgatitjen e projekteve te sistemeve telekomunikaciont, të monitorimit dhe automatizimit nese do kerkohet.

- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës do të jetë përgjegjës përgatitjen e projekteve të mbrojtjes ndaj zjarrit nëse do kërkohej.
- 1 (një) Ekspert Arkeolog/Restaurator do të jetë përgjegjës përgatitjen e projekteve restauruese apo të raporteve arkeologjike nëse do kërkohej
- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” do të jetë përgjegjës përgatitjen e projekteve në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 21 persona.

(Numri prej 21 personash përfshin 9 persona- personelin kryesor si dhe 12 persona- stafin mbështetës)
Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e kërkuar të deklaruar.*
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar të deklaruar.*

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station
- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike GPS.
- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike dron

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qira të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Për automjetin kur është në pronësi të paraqitet certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni dhe certifikata e kontrollit teknik. Për automjetet me qira krahas dokumentacionit të mësipërm të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë ku përfshihet periudha e shërbimit.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Paisjet gjeodezike, total station, gps, dron, janë të nevojshme sepse me anë të tyre do të bëhet rilevimi topografik i zones ku do të shtrihet investimi.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme:

- a. ISO 9001: 2015 *Për menaxhimin e cilësisë/ose ekuivalente;*
- b. ISO 14001: 2015 *Për menaxhimin e cilesisë së mjedisit/ose ekuivalente;*
- c. ISO 50001:2018 *Sistemi i Menaxhimit të Energjisë/ose ekuivalente;*
- d. ISO 39001:2012 *Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në transportin rrugor/ose ekuivalente;*
- e. ISO 45001:2018 *Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë/ose ekuivalente.*

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”
Certifikatat e cilesise janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës.

Certifikat: ISO 9001/2015 - Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësisë, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, siguri i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

Certifikat: ISO 45001 : 2018 - Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve *rates qe prokurohet*.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.5 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Sipas specifikimeve teknike bashkangjitur, të hartuara, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtim orë kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Në rastet kur citohet në dokumentet e tenderit të ngarkuara në SPE termi “cilësia e parë” ose “cilësi e I-rë” ose ndonjë “markë”, ky përcaktim të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasinë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Njësia e Prokurimit